



**Futboll Klub Dinamo**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E AKTIVITETEVE	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 12

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2021

Nr	AKTIVET	Periudha	Periudha
		31.12.2021	31.12.2020
4	Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	3,870	-
5	Të drejta	579,845	-
	Kontribute të arkëtueshme	-	-
	Investime financiare afat gjata	-	-
	Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje	-	-
6	Toka, ndërtesa dhe pajisje	1,229,597	-
	Investime të tjera afat gjata	-	-
	<b>Totali Aktiveve</b>	<b>1,813,312</b>	<b>-</b>
	<b>DETYRIMET</b>		
7	Të pagueshme	7,976,027	853,292
	Dëftesa të pagueshme	-	-
	Kontribute të marra në avancë	-	-
	Grante	-	-
	Premtime të kushtëzuara për të dhënë	-	-
	Hua afat gjatë	-	-
	<b>Totali Detyrimeve</b>	<b>7,976,027</b>	<b>853,292</b>
	<b>AKTIVET NETO</b>		
	Të kufizuara		
	a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
	b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash		
8	Të pakufizuara	- 6,162,715	- 853,292
	<b>Totali Aktiveve Neto</b>	<b>- 6,162,715</b>	<b>- 853,292</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Aktiviteteve  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Nr	Pershkrimi i zetit	Periudha	Periudha
		31.12.2021	31.12.2020
	Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
9	<b>Te ardhurat</b>		
	Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	7,017,900	
	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	17,323,691	-
	Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit		
	Të ardhura nga investimet apo dhurimet		
	Të ardhura nga e drejta televizive	-	
	Të ardhura nga aktivitetet tregtare		
	Të ardhura të tjera	26,124	
	<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara</b>	<b>24,367,715</b>	<b>-</b>
	<b>Aktive neto të çliruara nga kufizimet:</b>		
	Aktive neto të çliruara nga kufizimet:		
	Realizimi i kufizimeve të programit		
	Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		
	Përfundimi i kufizimit të afatit		
	<b>Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet</b>		
	<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:</b>		
	<b>Shpenzime për aktivitetet</b>		
	Aktiviteti A	-	-
	Aktiviteti B	-	-
	Aktiviteti C	-	-
10	Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	- 29,677,138	- 853,292
	Krijim dhe rritje fondesh		
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>- 29,677,138</b>	<b>- 853,292</b>
	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)</b>		
	<b>Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:</b>		
	Kontributet		
	Të ardhurat nga investimet afat gjata		
	Fitimi i realizuar dhe i porealizuar nga investimet afatgjata		
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
	Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)		
	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)</b>	<b>- 12,353,447</b>	<b>- 853,292</b>
	<b>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</b>	<b>- 5,309,423</b>	<b>- 853,292</b>
	Aktive neto në fillim të vitit	- 853,292	-
	Aktive neto në fund të vitit	- 6,162,715	- 853,292

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Nr	Pershkrimi i zerave	Periudha 31.12.2021	Periudha 31.12.2020
	Ndryshimet në aktivet neto	- 5,309,423	- 853,292
	Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto		
	me flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:		
	Amortizimi dhe zhvlerësimi	122,431	-
	Humbjet e realizuara dhe të perealizuara në investime	-	-
	Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve	-	-
	Kontributet jo në para	-	-
	Rritjet / Rëniet jo në para të inventarëve	-	-
	Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma	-	-
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:		
	Të tjera të arkëtueshme	- 579,845	-
	Shpenzime të parapaguara	-	-
	Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme	-	-
	Të pagueshme	7,122,735	853,292
	Bamirësi mbi baza vjetore		
	<b>Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>	<b>1,355,898</b>	<b>-</b>
	<b>AKTIVITETET INVESTUESE</b>		
	Blerje / Shitje investimesh	-	-
	Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata	- 1,352,028	-
	Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme	-	-
	Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme	-	-
	<b>Flukse neto nga aktivitetet investuese</b>	<b>- 1,352,028</b>	<b>-</b>
	<b>AKTIVITETET FINANCUESE</b>		
	Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma	-	-
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme	-	-
	<b>Flukse neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre</b>	<b>3,870</b>	
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	-	-
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	3,870	-
	<b>Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksas</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**“Futboll Klub Dinamo” OJF**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

---

(Vlerat janë në Lek)

**1. Informacion i përgjithshëm**

“Futboll Klub Dinamo” është një fondacion jo fitim prurës i regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr.1408 datë 09.05.2005.

Shoqata është e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me NIPT K51714031W. Adresa e Shoqatës është: Rruga Vaso Pasha, Hyrja 1, Ap.10, Tiranë.

Fusha e aktivitetit konsiston në mbikqyrjen, nxitjen e veprimtarisë sportive të ekipeve të futbollit të grup-moshave të cilat janë në përbërje të Shoqatës, të punojë në rritjen e nivelit sportiv dhe rezultateve të futbollistëve të saj me mënyra dhe metoda teknike sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, të nxisë kontaktet me shoqatat e tjera interesat e të cilave përputhen me ato të Shqipërisë, etj.

Taksat dhe kontributet: Veprimtaria e Shoqatës “Futboll Klub Dinamo”, Tiranë, duke qënë një organizate jo-fitim-prurëse, është e përjashtuar nga Tatimi mbi Fitimin, dhe të gjitha llojet e taksave dhe detyrimeve fiskale. “Futboll Klub Dinamo” është përgjegjës për Pagesen e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore të Stafit, Tatimit mbi Të Ardhurat Personale të Stafit, si edhe taksat e mbajtura në burim sipas Ligjit fiskal Shqiptar.

Numri mesatar i punonjësve të Shoqatës për vitin 2021 është 32 punonjës (2020:22 punonjës).

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

**2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

**2.4. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

## **“Futboll Klub Dinamo” OJF**

### **Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë në Lek)*

#### *Të pagueshme*

Të pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

## “Futboll Klub Dinamo” OJF

### Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

#### 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

##### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
Euro/ALL	120.76	123.7

#### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqata bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Të drejta dhe kontribute të arkëtueshme.*

Të drejta dhe kontribute të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqata do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Të drejta, licënca dhe të ngjashme	Vlerë e mbetur	15 %

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që shoqata do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje. Të ardhurat kryesore të shoqatës përbëhen nga: Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit, Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare, Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit, etj.

#### 3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë të shoqatës.

#### 3.7. Aktivitetet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i

## "Futboll Klub Dinamo" OJF

### Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

#### 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Llogari rrjedhëse	1393	0
Mjete monetare në arkë	2477	0
	<b>3870</b>	<b>0</b>

#### 5. Të drejta.

Të drejtat që Shoqata ka ndaj Shoqërisë F.C Dinamo në bazë të marrëveshjes së përbashkët ndërmjet dy subjekteve, detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Te drejta ndaj F.C Dinamo	579,845	-
	<b>579,845</b>	<b>-</b>

Gjatë vitit 2021, në bazë të marrëveshjes së përbashkët midis Shoqatës "Futboll Klub Dinamo" dhe subjektit "Futboll Club Dinamo"sha, shoqata ka kaluar fonde në favor të subjektit "Futboll Club Dinamo"sh.a si dhe ky i fundit ka kryer shlyer disa detyrime për llogari të "Futbol Klub Dinamo", dhe llogaria e mësipërme paraqet marrëdhënien financiare midis palëve në datën e mbylljes së pasqyrave financiare për vitin 2021.

**“Futboll Klub Dinamo” OJF**  
**Shënimet e pasqyrove financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**6. Aktive Afatgjata Materiale**

	Mobilje dhe orendi	Pajisje Informatike	Makineri dhe Pajisje	Te tjera	Total
<i>Kosto</i>					
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-	-	-	-	-
Shtesa	304,653	-	1,047,375	-	1,352,028
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>304,653</b>	-	<b>1,047,375</b>	-	<b>1,352,028</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	(35,149)	-	(87,282)	-	(122,431)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>(35,149)</b>	-	<b>(87,282)</b>	-	<b>(122,431)</b>
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>269,504</b>	-	<b>960,093</b>	-	<b>1,229,597</b>

**"Futboll Klub Dinamo" OJF**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

(Vlerat janë në Lek)

**7. Të pagueshme**

Të pagueshme përfaqësojnë detyrimet që ka shoqata ndaj palëve të treat, detyrimet për pagat, sigurimet dhe detyrime ndaj shtetit. Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Detyrime ndaj furnitoreve	6,878,187	
Paga te pagueshme	1,081,821	-
Detyrime per Kontributet e Sigurimeve	1,020	-
Detyrime per taksat vendore	15,000	
	<b>7,976,028</b>	<b>-</b>

Në bazë të marrëveshjes midis Shoqatës "Futboll Klub Dinamo" dhe subjektit "Futboll Club Dinamo"sha, të gjitha këto detyrime do të shlyhen nga shoqëria "Futboll Club Dinamo"sh.a. gjatë vitit 2022.

**8. Aktiviteti Neto të pakufizuara**

Aktiviteti neto të pakufizuara krijohen nga aktivitetet e përditshme të OJF-së, mbledhja e fondeve, donacionet e përgjithshme (pa kufizime të donatorëve), etj. OJF-ja është e lirë për të përdorur këto aktive në mënyrën që ajo e shikon të arsyeshme, në kuadër të objektivave të përgjithshëm të deklaruara nga njësia ekonomike, ligjeve përkatëse dhe çdo detyrimi kontraktual të nevojshëm për të përmbushur:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Aktive neto ne fillim te vitit	-853,292	0
Aktive neto ne fund te vitit	-6,162,715	0
	<b>-5,309,423</b>	<b>0</b>

**9. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 shoqata ka patur të ardhura nga burimet e mëposhtme:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	7,017,900	-
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	17,323,691	-
Të ardhura nga kurset e këmbimit	26,124	-
	<b>24,367,715</b>	<b>-</b>

**"Futboll Klub Dinamo" OJF**

**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

(Vlerat janë në Lek)

**10. Shpenzime administrimi**

Shpenzimet e administrimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Qira Zyre & Fushat	4,334,729	-
Shpenzime për medikamente	244,928	-
Shpenzime Klubi Padova	2,952,000	-
Udhetime dieta	782,540	-
Taksa vendore	15,000	-
Shpenzime telefoni, internet	18,500	-
Shpenzime bankare	24,851	-
Shpenzime të tjera	4,380,544	-
Penalitetet & kamatvonesat	374,985	-
Shpenzime amortizimi paisje etj.	122,431	-
	<u><b>13,250,508</b></u>	<u>-</u>

**10.1 Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Shpenzime paga punonjësish	13,185,277	352,000
Shpenzime për sigurime Shoqërore dhe shëndetësore	3,241,354	501,292
	<u><b>16,426,631</b></u>	<u><b>853,292</b></u>

Shpenzimet për benefitet e përllogaritura përfshijnë rimarrjen e shpenzimeve të përllogaritura për bonuset dhe ditët e pamarrë të pushimeve.

**Përgatiti**

Ilir SINANI

**Përfaqësuesi**

Ilir SINANI

